

Prishtinë, 07 nëntor 2025
Kodi i ZRRE-së: V_2932_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 39 dhe 40, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, (Rregulla ZRRE/Nr.08/2017), e datës 13 prill 2017,

në seancën e mbajtur më 07 nëntor 2025 nxori këtë:

V E N D I M

PËR HAPJEN E PROCEDURES SË RI-TENDERIMIT PËR ZGJEDHJEN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

- I. LEJOHET SHPALLJA/HAPJA E PROCEDURËS SË RI-TENDERIMIT për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF).
- II. Furnizuesit që aplikojnë për të ofertuar në procedurën e ri-tenderimit duhet të demonstrojnë se përmbushin kriteret e dhëna në nenin 4 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;
- III. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë i obliguar që të sigurojë të gjitha shërbimet e furnizimit ashtu si janë përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullin për kushtet e përgjithshme për furnizim me energji elektrike dhe Licencën përkatëse të lëshuar nga Rregullatori.
- IV. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të caktohet për një periudhë veprimi si furnizues i tillë, në pajtim me nenin 3 të Rregullës për FMF për periudhë tre (3) vjeçare.
- V. Si Furnizues i Mundësisë së Fundit do të zgjidhet furnizuesi i cili ofron koston më të ulët të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike, siç është definuar në Rregullën për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;
- VI. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të furnizojë konsumatorët që ngelin pa furnizues në rastet kur:
 - furnizuesi i tyre ka bankrotuar apo është në likuidim;
 - licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo i ka skaduar; dhe
 - konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

- VII. Konsumatorët e referuar në pikën VI të dispozitivit të këtij vendimi kanë të drejtë të shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për një periudhë jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.
- VIII. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të fillojë furnizimin me energji elektrike me ndërprerjen e kontratës së konsumatorit me furnizuesin e mëparshëm ose kur furnizimi fillon për konsumatorin e ri, por që kontrata nuk është nënshkruar me një furnizues tjetër.
- IX. Procedura e Ri-Tenderimit për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të udhëhiqet nga Rregullatori.
- X. Njoftimi për dorëzimin e ofertave nuk do të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë nga data e publikimit të njoftimit nga ZRRE.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) në pajtim me Nenin 3 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit me vendim formal vendos për hapjen e procedurës së tenderimit për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit.
- Në pajtim me nenin 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike, ZRRE ka përsëritur tenderin ku Bordi me 24 qershor 2022 ka nxjerrë vendimin nr. V_1516_2022 për hapjen e procedurës së tenderimit për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit. Me pas ZRRE ka bërë shpalljen e tenderit në web faqen zyrtare të saj dhe ka njoftuar palët e lincencuara për furnizim me energji elektrike për të paraqitur ofertat e tyre për ofrimin e FMF-së. Edhe ky tender ka dështuar pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në Nenin 4 të Rregullës nr. 08/2017 për Furnizues të Mundësisë së Fundit.
- Si rezultat i kësaj dhe në pajtim me Nenin 40 paragrafi 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, ku ndër të tjera thuhet: *“në rast se edhe tenderi i dytë dështon, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit me një akt të veçantë”*, Bordi i ZRRE me datë 29 korrik 2022, me vendimin nr. V_1544_2022 ka caktuar Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK SH.A) që të ushtrojë përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për periudhë tri (3) vjeçare duke filluar nga 31 korriku 2022 deri me 30 korrik 2025”.
- Me datë 28 mars 2025 Bordi ka nxjerrë vendimin me nr. V_2695_2025 për Hapjen e Procedurës së Tenderimit për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për arsye se me datë 30 korrik 2025 do të përfundonte afati kohor i detyrimit të KEK SH.A për të kryer funksionin e FMF-së.
- Me datë 12 qershor 2025 Bordi ka nxjerrë vendimin me nr. V_2762_2025 për caktimin e KEK SHA që PËRKOHËSISHT të ushtrojë funksionin e FMF-së për periudhë gjashtë (6) muaj, nga data 31 korrik 2025 deri me 30 janar 2026, pasi që ftesës për shprehje të interesit për të aplikuar në Tenderin për FMF, i publikuar me 19 prill 2025, nuk i ishte përgjigjur asnjë aplikues.

- Andaj, marrë parasysh faktin se afati kohor i këtij detyrimi për KEK SH.A pritët të përfundojë me 30 janar 2026 për ushtrimin e funksionit si Furnizues i Mundësisë së Fundit, Bordi i ZRRE-së, në pajtim me Nenin 40 të Ligjit për Energji Elektrike dhe dispozitat e cekura në hyrje të këtij vendimi, me qëllim që konsumatorët të mos mbesin pa furnizim me energji elektrike, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

XI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


XII. Vendimi hyn në fuqi në datën e aprovimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimi të vendimit ose data e publikimi të tij në faqen elektronike të Zyrës së Rregullatorit për Energji, cilado që ndodhë e fundit.


Vendimi iu dërgohet:


- Menaxherit të prokurimit
- Anëtarëve të komisionit të ZRRE-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar